

Nr. 439, Prot.

Tiranë, më 03.06.2022

Lënda: Njoftim mbi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar

Drejtuar: Anëtarëve të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar

Të nderuar,

Në mbështetje dhe zbatim të ligjit nr.10091/2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, nenit 9.4 dhe 17.2 të Statutit të Organizatës Profesionale të Audituesve Ligjorë” Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar”, Vendimit Nr.5, datë 08.02.2022 të Këshillit Drejtues, shkresës së dorëheqjes Nr.413 prot., datë 11.05.2022, të znj. Nuriona Bërdica dhe shkresës së dorëheqjes Nr.429 prot., 25.05.2022 të z. Erjon Sarçi, ju njoftojmë se më datë 14.06.2022, ora 11:30, pranë ambienteve të Hotel Tirana International, salla Akernia, do të zhvillohet Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme e Anëtarëve të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, me rend dite si më poshtë:

- Zgjedhjen e tre anëtarëve të Këshillit Drejtues, përfshirë dhe anëtarin e zëvendësuar me vendimin Nr.5, datë 08.02.2022 të Këshillit Drejtues, me anë të së cilit znj.Orjana Kalaja është zëvendësuar nga znj. Ilda Duhaxhiu.

Ju bëjmë me dije se në zbatim të nenit 17.2 kandidaturat për anëtarë të Këshillit Drejtues do t'i paraqiten Kryetarit të Këshillit menjëherë pas këtij njoftimi deri më datë 14.06.2022, ora 00:01.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

Berti Pashko



Kryetar i Këshillit Drejtues